

Për Kryetarin e Komunës së suharekës z Bali Muharremaj

Për Kryetarin e Asambles komunale z. Behxhet Kuçi

Për Asamblen e Komunës së Suharekës

Dat: 25. 04. 2023 Suharekë

26.04.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MAJRE NE DORËZIM		PRIMJENO - RECEIVED	
Nësi org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	181	26883	-

Këshilli për iniciativën e shpalljes qytetar nderi ish kryetarin e qytetit të Fellbahut nga Gjermania Z. Christoph Palm

Kërkesë:

I nderuar Kryetar i Komunës z Bali Muharremaj, i nderuari Kryetar i Asambles Komunale z. Behxhet Kuçi, të nderuar asambleist, këshilli për iniciativën e shpalljes qytetar nderi ish kryetarin e qytetit të Fellbahut nga Gjermania Z. Christoph Palm i përbërë nga **Blerim Kuçi, Sali Asllanaj, Refki Gollopeni, Ismet suka, Mejtım Bytyqi, Sadik Zogaj, Latif Destani, Fadil Hamzaj, Shani Shala, Ahmet Asllanaj** e të tjerë duke u bazuar në shembëlltyrën e liderit fisnik, mikut ton të devotshëm z. Christoph Palm, ju propozojmë që me një vendim dhe akt solemn të jepni titullin qytetar nderi për mikun e komunës tonë Z. Christoph Palm.

Arsyetim:

Z. Christoph Palm Së bashku me Ish kryetarin Ukë Bytyçi inauguruan Qendrën për Edukimin e të Rinjëve Shtëpia e Fellbahut, Ai e siguroi buxhetin financiar për 20 vite për programin e edukimit për të rinjë. Z. Palm së bashku me Z. Blerim Kuçi arritën marrveshjen e partneritetit mes Komunës së Suharekës dhe Komunës së Fellbahut, ka finacuar projekte për shtimin e kapaciteteve për ujin në qytetin e Suharekës, Ka finasuar dhe mbështetur vazhdimisht shoqatën kulturore Shqiptare që vepron në Fellbach, Ka mbështet në avansimin e bizneseve të Shqipëtarëve në Fellbach dhe së fundi si drejtor i Fondacionit Josef Wund ka dhuruar një donacion për paisjen me kompjuter të laboratorit kreativ në fushën e dizajnit në qendrën për edukim kreativ Shtëpia e Fellbahut, ne jemi të bindur që autoriteti i mikut ton z. Christoph Palm do të jetë zë i fuqishëm dhe ambasadori më i mirë i vendit tonë.

Biografia e shkurtër e Z Christoph Palm.

Christoph Martin Palm (lindur më 1 shtator 1966 në Waiblingen) është një politikan Gjerman i CDU. Ai ishte kryebashkiak i Fellbach nga viti 2000 deri në 2016 dhe anëtar i parlamentit të shtetit të Baden-Württemberg nga 2006 deri në 2011.

Jeta

Ai është djali i Guntram Palm, ish-ministër në Baden-Württemberg dhe gjithashtu kryebashkiak i Fellbach. Ai studioi mjekësi në Tübingen nga 1987 deri në 1988 dhe drejtësi nga 1988 deri në 1996. Gjatë studimeve u bë anëtar i vëllazërisë AV Igel.

Nga viti 2000 Palm ishte kryebashkiak i Fellbach dhe nga 2006 deri në 2011 anëtar i parlamentit shtetëror të Baden-Württemberg për CDU. Në vitin 2008 ai u rizgjodh kryetar bashkie me 71.2 për qind të votave.

Palm ka qenë nënkryetar i CDU Rems-Murr që nga viti 2010.

Më 2 mars 2016, Palm njoftoi se nuk do të ishte më i disponueshëm për një mandat të tretë si kryebashkiak i Fellbach. Mandati i tij përfundoi më 1 nëntor 2016. Pasardhësi i tij quhet Gabriele Zull.

Palm drejtor menaxhues i Fondacionit Josef Wund që nga viti 2017

Ne jemi të bindur që ky propozim do ti bëjë nderë Komunës tonë dhe mbetemi me shpresë që propozimi ynë të pranohet .

Me respect

Këshilli inicues

Për : Refki Gollopeni



064-187-499